

STRATEGIES OF TEACHING/LEARNING A FOREIGN LANGUAGE FOR SPECIFIC PURPOSES

STRATEGJITË E MËSIMDHËNIES/NXËNIES NË GJUHEN E HUAJ PËR QËLLIME SPECIFIKE

MARGARITA PACI, SILVANA VISHKURTI

Qendra e Gjuhëve të Huaja, Universiteti Politeknik i Tiranës, Sheshi “Nënë Tereza”, Nr. 4, Tiranë,
SHQIPËRI
margaritapaci@gmail.com

AKTET VI, 3: 259-264, 2013

PËRMBLEDHJE

Ky punim synon që, nëpërmjet analizës së detyrave të kursit dhe vëzhgimeve në klasë, të nxjerri në pah strategjitë e mësimdhënies/nxënies më të efektshme në mësimdhënien e gjuhës së specialitetit. Ne do të nisemi nga një analizë krahasuese e metodave të mësimdhënies/nxënies që përdoren në mësimin e gjuhës angleze dhe asaj frënge në Universitetin Politeknik të Tiranës. Në fillim do të parashtrohen disa parime pedagogjike që zbatohen në gjuhën e specialitetit duke e vënë theksin në përdorimin konkret të saj në situatat e komunikimit të ardhshëm profesional. Pastaj, do të paraqiten veçoritë që shfaq mësimdhënien e gjuhës së huaj për studentët e degëve inxhinierike si edhe nevojat që ata kanë ndaj saj për të arritur qëllimet e tyre profesionale. Në përfundim jepen rezultatet e eksperimentimit të këtyre strategjive në mësimdhënien e gjuhës së specialitetit duke veçuar ato që kanë pasur më tepër sukses.

Fjalë kyçe: strategjitë e të mësuarit, metalinguistikë, gjuhë specialiteti.

SUMMARY

This paper aims, through the analysis of the course assignments and class observations, to highlight the most effective strategies for teaching / learning a language for specific purposes. We will begin with a comparative analysis of the teaching / learning methods used in learning English and French in the Polytechnic University of Tirana. First, there will be previewed some pedagogical principles that are applied when learning a specialty language by emphasizing its use in the target situation. Afterwards there will be outlined the characteristics of teaching a foreign language to engineering students as well as their linguistic needs in order to achieve their professional goals. In conclusion there will be given the results of experimenting these strategies in the language for specific purposes teaching and there will be distinguished the ones that prove to be most successful.

Key words: learning strategies, metalinguistics, language for specific purposes.

Hyrje

Globalizimi i ekonomisë dhe i tregut të punës kërkon që si ekspertët dhe specialistët ashtu edhe të rinjtë e fushave të ndryshme të jenë të aftë të komunikojnë në gjuhë të huaja duke qenë se ndeshen me folës të gjuhëve të ndryshme.

Mirëpo, në një shoqëri gjithnjë e më ndryshim, ku lëvizja e njerëzve krijon mundësi të reja dhe të

ndryshme pune, gjithnjë e më shumë individë ndeshen me nevojën për tu trajnuar e ritrajnuar gjatë jetës së punës. “Do mund të mbijetojnë vetëm ata njerëz që kanë mësuar sesi të mësojnë; që kanë mësuar të përshtaten me ndryshimet; që kanë kuptuar se asnjë njohuri nuk është absolute dhe se vetëm procesi i marrjes së dijes krijon një baze sigurie. (Rogers :1969, f. 120)

Përballë këtij realiteti, një nga qëllimet e çdo formimi dhe institucioni arsimor duke përfshirë edhe Universitetin Politeknik të Tiranës është t'u lehtësojë studentëve procesin e të mësuarit duke i pajisur ata me strategjitë dhe mjetet për të arritur te dija me një ndihmë sa më të vogël nga mësuesi. Në fund të fundit, është e pamundur që mësuesi t'i mësojë gjithçka që mund t'i nevojitet studentit. Për rrjedhojë, pritet nga institucionet që ofrojnë mësimdhënien e gjuhëve të huaja që të përqafojnë një filozofi e cila i përgjigjet kërkesave të kësaj bote të re duke e kaluar vëmendjen nga mësuesi te nxënësi me qëllim që të rritet pavarësia e këtij të fundit. Prandaj mësuesi duhet të përqendrohet më shumë te mënyrat më të efektshme të të mësuarit sesa në përçimin e dijes. Kjo do të thotë se nuk mjafton që vetëm të krijohen veprimtari mësimore të mira dhe interesante apo të përzgjidhet një përmbajtjeje funksionale (si t'i përgjigjemi telefonit, si të shkruajmë një letër). Ne duhet të shohim mënyrat se si nxënësit mësojnë dhe cilat strategji përdorin kur kryejnë një detyrë dhe t'i stërvitim ata të reflektojnë rreth mënyrës se si ata vepruan gjatë zgjidhjes së detyrës.

Qëllimi i studimit.

Qëllimi praktik i kryerjes së këtij studimi është arritja e rezultateve sa më pozitive në mësimin e gjuhës së huaj dhe përdorimin e saj në situata të ndryshme të komunikimit profesional.

Para viteve '90 gjuha e huaj në Universitetin Politeknik të Tiranës, ishte e shtrirë në dy vite mësimore, gjë që i krijonte mundësinë studentit të konsolidonte dijet në gjuhë dhe të arrinte ta përdorte atë në fushën e profesionit. Aktualisht, me programet e reja gjuha e huaj mësohet vetëm në vitin e parë dhe vetëm një semestër. Të ndodhur përpara faktit të pakësimit të orëve të mësimin të gjuhës së huaj në UPT pedagogët u përpoqën të gjenin mënyra të reja të arritjes së synimeve të tyre për përvetësimin e gjuhës së huaj nga studentët.

Një nga metodat që ata eksperimentuan ishte dhe njohja e ndërjegjësimi i studentëve me mënyrat e strategjitë që ata përdornin në

mësimin e gjuhës së huaj. Mjetet që u përdorën ishin të shumëllojshme (puna individuale apo në grup, në klasë apo jashtë saj, me apo pa ndihmën e mësuesit). Ato synonin ta shndërronin studentin nga një individ pasiv në një njeri aktiv që reflekton mbi mënyrën se si vepron dhe është gjithmonë në kërkim të mundësive të reja për t'ia përshtatur ato situatës në të cilën ndodhet.

Meqenëse si gjuha ashtu dhe njohuritë në fushën e profesionit mbahen gjallë vetëm nëpërmjet rifreskimit dhe përdorimit të vazhdueshëm të tyre këto strategji do ta edukonin studentin me dëshirën për dije dhe kërkimin e mënyrave të reja të përvetësimit të saj.

Në këtë mënyrë, ai do ta kuptojë vlerën e të mësuarit dhe do të jetë i motivuar për të mësuar më shumë jo vetëm në shkollë, por edhe pas mbarimit të saj, duke i konceptuar shkollën dhe punën si vazhdimësi të njëra-tjetrës dhe jo si dy formime të ndryshme e pa lidhje ndërmjet tyre.

Materialet dhe Metodat

Konteksti i përgjithshëm i Studimit

Zbatimi i Kartës së Bolonjës në Universitetin Politeknik të Tiranës më 18 shtator 2003 rezultoi në pakësimin e orëve për mësimin e gjuhës së huaj në këtë universitet. Për më tepër që ne jetojmë në një shoqëri dhe ekonomi botërore gjithnjë në ndryshim. Së këndejmi lind nevoja për zhvillimin e strategjive të mësimnxënies/mësimdhënies që rrisin autonominë e studentit dhe lehtësojnë marrjen e dijes

Kuadri Teorik

Për shkak të sasisë së lartë të informacionit që duhet të përpunojnë studentët gjatë mësimin të një gjuhe të huaj, ai duhet të përdorë strategjitë të ndryshme për të përvetësuar ato punuar. Këto strategji janë tregues të mënyrës sesi ata u qasen një detyre apo problemi të hasur gjatë mësimin të gjuhës së huaj. Pra, strategjitë për mësimin e gjuhës janë veprime apo teknika të veçanta që përdorin studentët për të mësuar një gjuhë të huaj (Oxford, 1990). Ato i sigurojnë mësuesit të dhëna rreth mënyrës sesi studentët vlerësojnë situatën, planifikojnë dhe përzgjedhin teknika për

të kuptuar, mësuar dhe mbajtur mend të dhënat e reja të marra në mësim. Shumë studiuues mendojnë se përdorimi i vetëdijshëm i strategjive të të mësuarit lehtëson mësimin e gjuhëve të huaja. (Naiman, FROHLICH & Todesco, 1975, Venden, 1985). Gjithashtu ata mendojnë se përcaktimi i strategjive të përdorura nga nxënës më të suksesshëm në mësimin e gjuhës së huaj mund t'i ndihmojë ata më pak të suksesshëm. Prandaj, nëse mësuesi i gjuhës di më shumë rreth strategjive efektive që nxënësit e suksesshëm përdorin, ato mund të jenë në gjendje t'i mësojnë këto strategji efektive nxënësve më pak të zotë për të rritur aftësitë e tyre gjuhësore.

Llojet e strategjive të përdorura nga studentët ndryshojnë për shkak të faktorëve të ndryshëm, të tilla si shkalla e vetëdijes, faza e të mësuarit, kërkesat e detyrës, pritjet e mësuesve, mosha, gjinia, kombësia/etnia, stili të mësuarit, tipare të personalitetit, niveli i motivimit, dhe qëllimi për mësimin e gjuhës (Oxford, 1990).

Shumë studiuues kanë bërë një klasifikim të këtyre strategjive, por pothuajse të gjithë dallojnë tri kategori kryesore:

- Strategji metakonjiktive
- Strategji njohëse
- Strategji socioafektive

Strategjitë metakonjiktive kanë të bëjnë me reflektimin rreth procesit të të mësuarit, monitorimin, planifikimin dhe vlerësimin e tij pas përfundimit të një veprimtarie. Nga ana tjetër, strategjitë njohëse janë më të kufizuara te detyra të veçanta mësimore dhe ato përfshijnë manipulimin më të drejtpërdrejtë të materialit mësimor. Përsëritja, përkthimi, grupimi, mbajtja e shënimeve, deduksioni, rikombinimi, përdorimi i fjalëve kyçe, kontekstualizimi, përpunimi, transferimi, nxjerrja e konkluzionit janë ndër strategjitë njohëse më të rëndësishme. Për sa i përket strategjive socioafektive, mund të thuhet se ato janë të lidhura me veprimtari të ndërmjetësimit dhe ndërveprimit me të tjerët. Bashkëpunimi dhe bërja e pyetjeve për sqarime janë strategjitë socioafektive kryesore.

Sipas Fedderholdt (1997:1), ata studentë që mund të përdorin një shumëllojshmëri strategjish

të mësimin të gjuhës mund të përmirësojnë aftësitë e tyre gjuhësore më së miri. Strategjitë metakonjiktive përmirësojnë organizimin e kohës së mësimin, vetë-monitorimin, dhe vetë-vlerësimin. Strategjitë njohëse përfshijnë përdorimin e njohurive të mëparshme për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve të reja. Strategjitë socioafektive kanë të bëjnë me bashkëpunimin me një folës vendas apo shok klase për të përmirësuar shqiptimin ose për të punuar së bashku në një problem të veçantë të gjuhës. Përvetësimi i këtyre tri strategjive, metakonjiktive, njohëse, dhe socioafektive mund të ndihmojë nxënësin për të fituar autonomi dhe të mund të marrë kontrollin e të mësuarit e tij.

Kampioni

Përzgjedhja e kampionit të këtij studimi është thjesht rastësore. Ai përbëhet prej 134 studentë të cilët pranuan vullnetarisht të merrnin pjesë në anketimin i cili u zhvillua në ambientet e UPT-s sipas fakulteteve ku studentët kryenin formimin e tyre gjatë vitit shkollor 2011-2012. Ata janë në vitin e parë dhe të dytë dhe studiojnë në degët inxhinierike: Gjeodezi, Mekatronike, Elektrike, Mjedis, Ndërtimi dhe Mekanike. Marrja e një kampioni të tillë, sipas degëve më kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës synonte të përzgjidhte strategjitë më të përdorura nga studentët me qëllim që të përforcojmë ato më efikasitet si dhe të përfshijmë strategji të tjera që do t'u lehtësojnë atyre përpunimin në gjuhën e huaj dhe nëpërmjet saj në fushën e specialitetit.

Mjetet dhe Procedura

Të dhënat u mbledhën gjatë një semestri, përkatësisht semestri i parë për degët Inxhinieri Gjeodezi, Mekatronike, Elektrike, Mekanike dhe Ndërtimi dhe semestri i dytë për Inxhinierinë e Mjedisit.

Për vjeljen e të dhënave u përdorën tri mjete kryesore: I pari ishte një **pyetësor** për të zbuluar strategjitë e nxënies së studentëve, veçoritë individuale dhe nevojat e tyre dhe në veçanti stilet e tyre të të mësuarit. Me qëllim që studentët të ndiheshin të lirë të shprehnin mendimet e tyre, nuk iu kërkua me detyrim të

jepnin emrat e tyre dhe as grupin të cilit i përkisnin. Pyetësi iu paraqit studentëve në gjuhën shqipe për të shmangur çfarëdolloj keqkuptimi.

Mjeti i dytë ishte një test niveli i njohurive të përgjithshme të studentëve në gjuhën angleze. Në bazë të direktivave të MASH-it, studentët që vazhdojnë studimet universitare duhet të jenë në nivelin B1 (duke u mbështetur në përcaktimin e niveleve sipas KEPRG), por përvoja ka treguar që ata mund të jenë të niveleve të ndryshme duke filluar nga A1 dhe deri te nivelet e avancuara siç janë B2 dhe C1. Prandaj është shumë e rëndësishme të përcaktohet niveli i tyre i zotërimit të gjuhës angleze me qëllim që të përcaktohen strategjitë për tu përballur me këtë heterogjinitet nivelesh. Për më tepër që përzgjedhja e aftësive më efikase të të nxënit ndikohet nga niveli i zotërimit të gjuhës së huaj, Ky test, gjithashtu shërben për të konfirmuar ose korriguar vlerësimin që studentët i bënë vetes gjatë plotësimit të pyetësorëve. Ai përbëhet nga dy pjesë: 30 pyetje gramatikore dhe 4 tekste ku intensiteti i vështirësive kalonte nga niveli fillestar deri tek nivelet e përparuara.

Përveç testit me shkrim u realizua edhe një intervistë në formën e bisedës e cila përbëhet nga 15 pyetje. Shtatë pyetjet e para kërkonin përgjigje të shkurtra ndërsa tetë të tjerat ishin pyetje të hapura me qëllim që të nxisnin tek studentët të menduarit kritik teksa shtjellonin përgjigjet e tyre. Vlerësimi i studentëve u realizuar sipas një rubrike përgatitur paraprakisht. Ky 'provim me gojë' synonte të konfirmonte nivelin e studentëve që rezultoi nga testi me shkrim.

Duke qenë se studentët shpesh herë nuk janë të ndërgjegjshëm për strategjitë e të mësuarit, u pa e domosdoshëm **vrojtimi i sjelljes së tyre në klasë**, nëse kërkonin sqarime, korrigjime, punonin më vete apo bashkëpunonin me shokët.

REZULTATET DHE DISKUTIMI

Analiza e të dhënave

Nga testi i nivelit rezultoi se 134 studentët e anketuar ishin të niveleve të përziera ku shumica (43,7%) ishin në nivelin mesatar, të ndjekur nga

30,4% të përparuar dhe vetëm 25,9% ishin fillestar.

Niveli	Përqindja (%)
Fillestar	25,9
Mesatar	43,7
I Përparuar	30,4

Tabela 1. Niveli i studentëve në gjuhën angleze

Këtë heterogjinitet nivelesh e gjejmë edhe nëpër grupe të vogla prej 20-30 studentësh. Për shembull më poshtë po japim nivelet e studentëve brenda grupeve, përkatësisht Gjeodezi IB dhe Ndërtim IF në vitin akademik 2009-2010.

Niveli	Përqindja (%)
Fillestar	27,8
Mestar	72,2

Tabela 2. Niveli i studentëve të grupit Gjeodezi IB

Niveli	Përqindja (%)
Mesatar	54,5
I Përparuar	45,5

Tabela 3. Niveli i studentëve të grupit Ndërtim IF

Ndërsa nga pyetësorët rezultoi se studentët paraqesin një shumëllojshmëri stileshe të të mësuarit por, në të njëjtën kohë, paraqesin një preferencë për metodat tradicionale të nxënies me mësuesin në qendër. Studentët e konsiderojnë shumë të kënaqshme një 'mësim të drejtuar nga mësuesi dhe me shpjegime'. Atyre nuk u pëlqen të punojnë në grupe dhe as me një student tjetër. Por nga ana tjetër, ka edhe studentë mësojnë më mirë kur e shohin ose e dëgjojnë diçka dhe kur marrin pjesë nëpër veprimtari krijuese si projekte apo detyra kursi. Së fundi nga vrojtimi i sjelljes së studentëve në klasë u vu re se studentët fillestar parapëlqenin më shumë të përdornin strategji njohëse si përsëritja, përkthimi dhe mbajtja shënim dhe studentët mesatar dhe të përparuar preferonin strategji të tilla si: grupimi, rikombinimi, përpunimi, nxjerrja e konkluzioneve dhe

deduksioni te. Strategjitë metakonjitive gjithashtu ishin më shumë të përqendruar tek studentët e përparuar. Ndërsa strategjitë socioafektive ishin më pak të preferuara nga studentët ndoshta për shkak të faktit se në sistemin arsimor shqiptar studentët vlerësohen individualisht dhe jo nga puna në grup.

Niveli i zotërimit të gjuhës ndikonte në përdorimin e strategjive të nxënies. Studentët e përparuar përdornin më shumë dhe më shpesh strategji nxënieje se ata fillestar dhe mesatar

Interpretimi i të dhënave

Nga analiza e të dhënave të marra nga pyetësi, testi i nivelit dhe vrojtimi i sjelljes së studentëve në klasë rezultoi se kemi të bëjmë me një kontigjent heterogjen studentësh jo vetëm nga niveli i njohurive të tyre të zotërimit të gjuhës por edhe nga motivimi, stilet e të mësuarit dhe strategjitë e nxënies. Dhe siç thotë Rinvolucri (1986), ne nuk i japim mësim një grupi prej 30 vetë por 30 personave të veçantë. Përmëtepër që sa më i madh të jetë grupi aq më shumë thellohet problemi.

Për këtë arsye mësuesi i gjuhës së huaj duhet të përdorë një gamë të gjerë strategjish në mënyrë që të plotësojë nevojat, pritshmëritë e studentëve që zotërojnë stile të ndryshme të mësuarit, nivele motivimi dhe strategjish, etj. Prandaj, mund të thuhet se është shumë e rëndësishme që gjatë mësimdhënies së gjuhës së huaj të ofrohen një sërë tipash detyrash në përputhje me stile të ndryshme të të mësuarit, si p.sh. 1. Të përdoren një shumëllojshmëri temash dhe përmbajtjesh. Në këtë mënyrë studentët kanë të ngjarë që të ndihen më të interesuar. 2. Të caktohen detyra të hapura (open-ended tasks) në mënyrë që studentët t'i plotësojnë sipas nivelit të tyre. 3. Të ofrohen veprimtari me nivele të ndryshme vështirësie apo edhe duke u dhënë atyre detyrat më të vështira. 4. Të organizohen studentët në grupe në mënyrë që të ndihmojnë njëri-tjetrin. 5. Në disa raste, të grupohen edhe sipas nivelit me qëllim që askush të mos ndihet i turpëruar për saktësinë e përmbushjes së detyrave në klasë. 6. Të ndihmohen studentët me vështirësi dhe t'i

ofrohen materiale shtesë atyre që iu nevojiten ose më të përparuarve.

Natyrisht që zgjidhja më e mirë do të ishte grupimi i studentëve sipas nivelit të zotërimit të gjuhës dhe preferencave, por për momentin kjo nuk është e mundur në UPT.

Konkluzione

Mësuesit nuk do të jetë në gjendje t'i mësojnë studentëve të gjitha aftësitë gjuhësore që do t'i duhet në të ardhmen. Kështu që ata duhet të mbështet në përdorimin e strategjive të të mësuarit. Ato janë çelësi i ndërtimit të autonomisë së studentit.

Duke qenë se studentët paraqesin stile të ndryshme të mësuarit, mësuesi do t'i duhet të përdori një gamë të gjerë strategjish në mënyrë që çdo student të gjej veten. Përveç kësaj, mësuesi mund të prezantojë dhe shpjegojë strategjitë të ndryshme të të mësuarit duke i shpjeguar qëllimin dhe rëndësinë e tyre. Madje ata mund të diskutojnë hapur se pse një strategji funksionon më mirë dhe kur mund të përdoret. Në këtë mënyrë, rritet repertori i mjeteve mësimore për secilin student duke i bërë atë më të vetëdijshëm për strategjitë në dispozicion të tij dhe për ti inkurajuar që të vendosin se cilat strategji janë më efikase për të arritur te qëllimi primar që është marrja e dijes në mënyrë të pavarur.

Bibliografia

1. Ehrman, M. E. & Oxford, R. L. (1989). Effects of sex differences, career choice, and psychological type on adult language learning strategies. *The Modern Language Journal*, 73(1), 1-13.
2. Green, J.M. & Oxford, R.L. (1995). A closer look at learning strategies, L2 proficiency, and gender. *TESOL Quarterly*, 29(2), 261-97.
3. O'Malley, J. M., Chamot, A. U., Stewner-Manzanares, G., Russo, R. P. and Kupper, L. J. (1985). Learning strategy applications with

- students of English as a second language. *TESOL Quarterly*, 19, 557-584.
4. O'Malley, J. M., & Chamot, A. U. (1990). *Learning Strategies in Second Language Acquisition*. New York: Cambridge University Press.
 5. Oxford, R. L.(1986). Second language learning strategies: Current research and implication for practice. ERIC Document Reproduction Service No. ED 278273.
 6. Oxford, R. L. (1989). Use of language learning strategies: a synthesis of students with implications for strategy training. *System*, 17(2), 235-247.
 7. Oxford, R.L. (1990). *Language learning strategies: what every teacher should know*. Boston: Heinle & Heinle.
 8. Oxford, R. L. & Burry-Stock, J. A. (1995). Assessing the use of language learning strategies worldwide with the ESL/EFL version of the strategy Inventory for Language Learning (SILL). *System*, 23(2), 153-175.
 9. Oxford, R. L. & Ehrman, M. (1995). Adults' language learning strategies in an intensive foreign language program in the United States. *System*, 23(3), 359-386..